



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2710/Prot.
8

Patos, më 13/10/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 10 TETOR 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i njësise administrative Ruzhdie, *rreth 17 pjesëmarrës (banorë dhe kryetarë të fshatrave)*

Takimin hapet nga Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli

Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit

nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026", jemi këtu sot për të prezantuar materialin mbi Paketën Fiskale 2026. Ju ftoj të ndjekim prezantimin dhe më pas mund të presim komentet dhe suhjerimet tuaja.

Përgjegjës i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Endrit Adushaj—përshëndetje të gjithëve! Në këtë dokument do të prezantohen propozime të Bashkisë për



**Përgjegjës
z. Endrit Adushaj**

**Dëgjese publike me temë:
"Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026"**

Tetor 2025

sistemin e taksave dhe tarifave për periudhën një vjeçare. Kemi shtimin e disa tarifave të reja. Do të flasim për afatet të cilat do të kryhen këto pagesa dhe agjentët tatimor për vlejlen e këtyre detyrimeve. Baza ligjore mbi të cilën jemi bazuar për ndërtimin e Paketës Fiskale Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Llojet e taksave që propozohen për vitin 2026 janë: Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, taksa e fjetjes në hotel, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa e kalimit të drejtës së pronësisë, taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, taksa e Rentës minerare, taksa e Tabelës. Taksa e tokës bujqësore nuk do të ketë ndryshime, por do të qëndrojë në të njëjtat nivele. Propozojmë për këtë vit që çdo pagesë që do të kryhet brenda muajit gusht 2026 do të ketë lehtësirë prej 20%, nëse bëhet kjo pagesë para muajit gusht. Taksa e ndërtesës ka disa përjashtime për pensionistët që nuk kanë fëmijë në ngarkim. Te toka bujqësore kemi lehtësira në rastin e fatkeqësive natyrore. Tarifat janë propozuar me një rritje për këtë vit për dy fshatrat që ofrohet shërbimi i pastrimit si Ruzhdia dhe Gjynoqara. Propozojmë që tarifa e pastrimit të jetë 1500 lekë të reja dhe tarifa e shërbimit komunitar 800 lekë të reja. Kasnica, Siqeca dhe Drenia e kanë tarifën zero. Janë oarashikuar përjashtimet e tarifave për pensionistët e vetmuar. Invalidët e kanë tarifën zero, veteranët e luftës dhe banor

të skemës së ndihmës ekonomike. Kjo është një përmbledhje e paketës për vitin 2026. Presim diskutime nga ana juaj.

Kryetar i fshatit Siqec, z. Myftar Sorraj- Po Siqeca ku do ti hedhi këto mbeturina? Ne nuk na ofrohet shërbimi dhe ne e kemi tarifën zero, por nuk kemi ku të depozitojmë këto mbetje. Në Siqec ka shumë familje që janë larguar dhe nuk paguajnë taksat. Duhet parë një



**Kryetar i fshatit Siqec
z. Myftar Sorraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

mekanizëm që të vjelim edhe taksat e këtyre familjeve të larguara.

Drejtor ASHP, z. Eneo Xhaferri- Për pjesën e lagjeve që nuk marrin shërbim kemi



**Drejtor ASHP
z. Eneo Xhaferri**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

parashikuar që të pajisen me vende të depozitimit të koshave dhe të shkojnë makinat e pastrimit ti marrin siç shkojnë në Ruzhdie, Gjynoqarë. Ne do ju ofrojmë shërbimin dhe ju më pas do tarifoheni. Do pajisen të gjitha fshatrat me kosha.

Përgjegjës i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Endrit Adushaj- Për pjesën e vjeljes së taksave ne kemi filluar me shpërndarje e faturave në çdo banesë dhe familje për ti njohur me detyrimet e prapambetura. Në zonën tuaj nuk kemi filluar ende, por do të vijojmë së shpejti duke njohur dhe shpërndarë çdo faturë në banesë duke i njoftuar për detyrimin që ata kanë.



**Përgjegjës
z. Endrit Adushaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Banor i Ruzhdies- unë kam një tokë në emër të gjyshit që ka ndërruar jetë nga kjo tokë kanë përfituar të gjithë xhaxhallarët. Tani unë pengohem të marr shërbim pasi anëtarët e tjerë nuk pranojnë të pagujnë. Unë dua të paguaj pjesën time të AMTP.

Përgjegjës i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Endrit Adushaj- Taksat paguhen në emër të kryefamiljarit dhe ju do të paguani vetëm për pjesën tuaj të sipërfaqes që keni përfituar. Ju do të paguani vetëm pjesën tuaj sipas përbërjes familjare.



**Përgjegjës
z. Endrit Adushaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Kryetar i fshatit Siqec, z. Myftar Sorraj- Kemi dy javë pa ujë në fshatin Siqec. Si do zgjidhet kjo pjesë?



**Kryetar i fshatit Siqec
z. Myftar Sorraj**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Ky është një problem i madh dhe ne ju kemi



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

gjetur një zgjidhje të përkohshme duke ju siguruar një autobotë me ujë, por jemi në fazën e karburantit shumë të limituar, por do përpiqemi ta zgjidhim këtë problem derisa ujësjellsi të bëjë edhe shtrirjen e projektit edhe në zonën tuaj.

Administrator i njësisë Ruzhdië, z. Agim Mesutaj- kemi probleme me rrugët e parcelave,



**Administrator
z. Agim Mesutaj**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

pasi vjen sezoni vjeljes së ullinjve tani. Gjysma e Gjynoqarës, Siqec, Ruzhdië dhe Drenie janë pa ndërhyrë.

Drejtor i ASHP, z. Eneo Xhaferri- Punë për hapjen e rrugëve bujqësore janë bërë, por duke qënë se skrepi dhe traktori patën një defekt u vonua pak puna. Duhet të theksojmë faktin se janë shumë rrugë bujqësore në zonën tuaj dhe jemi duke punuar me ritme të shpejta. Në Gjy노qarë ka bërë gati 10-11 km rrugë bujqësore. U hap dhe rruga e Drenies dhe Vloshit më përpara.



**Drejtor
z. Eneo Xhaferri**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Zv/ Kryetar e bashkisë, znj. Ina Sauli- Nëse nuk keni ndonjë koment apo diskutim tjetër e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjesë publike. Ju falenderoj që u bashkuat!



**Zv/ Kryetar e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Armand Ahmetaj